



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.110/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.110/2019 e datës 27.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP më datë 27.09.2019, me të cilën pretendon se në tubimin hapës të fushatës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), më datë 26 shtator 2019, rreth orës 20:00, janë parë fëmijë të veshur me simbole të subjektit politik në fjalë, duke përfshirë kapelë dhe flamuj në duar, fotografi këto të nxjerra nga web faqja zyrtare e facebook-ut të PDK-së, me të cilat veprime paraqitësi i ankesës pretendon se është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për *“Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”*, respektivisht neni 5 par.2 dhe 3 i rregullës në fjalë.

Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigje në ankesë të datës 28.09.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), lidhur me pretendimet ankimore të Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ka theksuar se ata nuk konsiderojnë se nga ana e tyre është bërë ndonjë shkelje e cila bie ndesh me dispozitat e LZP-së, duke shtuar se pamjet në foto për pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatë zgjedhore në rastin konkret nuk dëshmojnë moshën e tyre, dhe për më tepër pretendojnë se kanë siguruar pëlqimin e prindit të fëmijës i cili shihet në foto dhe atë në formë të një dekaltrate të cilën prindi i fëmijës e ka dhënë përmes viber-it, në pamundësi ta jap në formën e kërkuar ligjore, me arsyen sipas tyre se gjendet në pushime.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë, si dëshmi për pretendimet e veta, ka bashkangjitur deklaratën e prindit të fëmijës në foto të dhënë përmes viber-it, kartën e identitetit të prindit, një foto të tij me fëmijën si dhe një njoftim që kandidati për kryeministër të Kosovës nga radhët e PDK-së, u ka bërë anëtarëve dhe simpatizantëve të tij për respektimin e rregullave zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk shihet që subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka promovuar program politik duke përfshirë fëmijë nën moshën 15 vjeçare në fushatë zgjedhore. Nga fotografitë vërehet se është mbajtur një tubim, në të cilin kanë qenë prezent edhe fëmijë të mitur, por nuk ka dëshmi se këta fëmijë janë përdorur në fushatën e zgjedhjeve nga ana e subjektit politik PDK, pasi që nga fotografitë nuk shihet se fëmijët kanë mbartur ndonjë pankartë apo ndonjë lloj tjetër të materialit promovues zgjedhor, gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore të zhvilluar nga ana e PDK-së.

Pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për "Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike", respektivisht nenin 5 par.2 dhe 3 të rregullës në fjalë, nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Paneli vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore, me të cilat sanksionohet pjesëmarrja në fushatë zgjedhore e personave të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjeç. Andaj në mungesë të provave, paneli e refuzoi ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova,, me seli në Prishtinë.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.110/2019 më datën 30.09.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.